

## Fletë informacioni nga IAM per kontrollin e kompetencës në këshillimin arsimor (KCH BiBe)

Ju keni pyetje në lidhje me punën? Doni të përmirësoni njohuritë tuaja gjuhësore, të ndërgjegjësoheni për aftësitë tuaja profesionale dhe pikat e forta? Dëshironi të krijoni një profil kompetencash apo të testoni në praktikë kompetencat tuaja formale/joformale?

### **Oferta jonë e këshillimit:**

- ▶ Analiza e kompetencave
- ▶ Krijimi i një profili kompetencash të detajuar
- ▶ Përgatitja për kursin “Kompetent drej së ardhmes – Trajnim i specializuar, gjermanishtja me një kontroll aftësish”
- ▶ Raportim i detajuar mbi kompetencat e konstatuara formale/joformale dhe aftësive praktike
- ▶ Kërkim pune
- ▶ Këshillim mbi arsimin
- ▶ Këshillim për kurset e gjermanishtes
- ▶ Informacion mbi shkollimin profesional dhe arsimin e mëtejshëm
- ▶ Mbështetje për njohjen e profesionit
- ▶ Përgatitje e dokumenteve të aplikimit etj.

### **Kush mund të marrë këshillim?**

**Personat që kanë të drejtë për azil, përfituesit e mbrojtjes shtesë, shtetas/e të BE-së, shtetas të vendeve të treta, të cilët janë të regjistruar në AMS.**

### **Si bëhesh pjesë e projektit?**

*1. Pranimi në këshillimin tonë klasik për politikën e tregut të punës  
„IAM Classic“*

- ▶ Këshilltaret/ët do t'ju mbështesin individualisht, p.sh. për çështjen e kurseve të gjermanishtes, arsimin e mëtejshëm, punën, etj.
- ▶ Nëse keni arritur nivelin gjuhësor A2 dhe keni kompetencat e duhura formale ose joformale, do të përcillen në projektin "Kontrolli i kompetencave, këshillim arsimor".

2. Pranimi në projektin "Kontrolli i kompetencave, këshillimi arsimor"

- ▶ Këshilltarët krijojnë profilin për aftësitë tuaja personale dhe ju do të përpunoni së bashku një plan karriere, i cili do të zbatohet në mënyrë aktive.
- ▶ Për njerëzit me nivel gjuhësor A2 dhe kompetenca formale/joformale, ekziston mundësia të marrin pjesë në kursin "Kompetent drejt së ardhmes – Trajnim i specializuar, gjermanishtja me një kontroll aftësish".

3. (Nëse është e nevojshme) Pjesëmarrja në kursin "Kompetent drejt së ardhmes – Trajnim i specializuar, gjermanishtja me një kontroll aftësish" (tek ofruesit e kurseve)

- ▶ Ndjekja e një kursi të gjermanishtes për arritjen e nivelit B1 duke përfshirë mundësinë e praktikës dhe
- ▶ testim praktik i kompetencave formale dhe joformale përmes qendrave të trajnimit.
  - ▶ Deri më tani janë kryer teste praktike në fushat e IT (aplikacione zyre, Photoshop, AutoCAD, hardware), fotografi, aktivitete zyre/administrative, kontabilitet, shitje, rrobaqepësi, parukeri, kozmetikë, gastronomi (shërbim/bar/kuzhinë/ pjekje ), inxhinieri elektrike, lyerje, përpunimi i metaleve, saldim, ndërtim (tullat, kallëpet), shtrim pllakash, mekanikë dhe zdruckhtari.

4. Përmbledhje e kompetencave të konstatuara nga këshilltarët/ët e IAM dhe mbështetje në integrimin në tregun e punës dhe gjetjen e shkollimit profesional të përshtatshëm dhe arsimimit të mëtejshëm.

**Ju do të shoqëroheni dhe mbështeteni me kompetencë nga ekipi i IAM gjatë gjithë procesit.**

**Këtu janë detajet tona të kontaktit:**  
**IAM – Instituti për Migrimin për Punë**  
**Gabelsbergerstraße 13 / 1. Stock**  
**9020 Klagenfurt am Wörthersee**  
**Tel: +43 (0) 463 509 301**  
**Fax: +43 (0) 463 509 301-20**  
**E-Mail: [info@iam.co.at](mailto:info@iam.co.at)**

Organizata jonë është e hapur për ju çdo ditë nga ora 08:00.  
Takimet për këshillim lihen me telefon në numrin 0463 509301.  
Jeni të mirëpritur të na e dërgoni kërkesën tuaj edhe me email ([info@iam.co.at](mailto:info@iam.co.at)).

**Keni pyetje? Ju presim me kënaqësi!**